



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .05.2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT QYTETAR NDERI I BASHKISË KOLONJË

Z. NIKOLLA DHE RIGOLETA BENDO

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 ,neni 55 si dhe VKB Kolonjë Nr.62 datë 25.09.2016 “Miratimin e llojeve të titujve të nderit në Bashkinë Kolonjë” ligjit 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë. Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës 30.05.2025:

PROPOZOI:

1.Dhënien e titullit “QYTETAR NDERI I KOLONJËS” Z.Nikolla Bendo me motivacion: *“Në vlerësim të lartë të kontributit të jashtëzakonshëm shumëdekadësh në shërbim të shëndetit të komunitetit të Kolonjës, si mjek dhe kirurg i përkushtuar. Për profesionalizmin humanizmin dhe ndershmërinë me të cilën ka udhëhequr shërbimin kirurgjikal në Spitalin e Ersekës. Për rolin e tij si një figurë shëmbullore që ka lënë gjurmë të thella në jetën publike të qytetit. ” dhe Znj.Rigoleta Bendo me motivacionin “Në vlerësim të kontributit të shquar si mjeke gjinekologe dhe shefe e shërbimit në Spitalin e Ersekës për mbi 25 vite, ku me përkushtim, profesionalizëm dhe kujdes të jashtëzakonshëm, shërbeu në mbrojtje të jetës së grave dhe fëmijëve. Për figurën e saj të nderuar në fushën e mjekësisë, e vlerësuar me “Urdhrin e Mjekut”, dhe për ndikimin e saj të palëkundur në shëndetin publik të rajonit.*

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit.

3.Ky vendim hyn në fuqi në mbështetje të nenit 55, pika 6 të ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Në mungesë dhe me urdhër
Nënkryetar
Petro Risto

Kryetari
Erion ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 2456 prot

Datë 23 05. 2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë . .2025

PËR DHENIEN E TITULLIT QYTETAR NDERI I BASHKISË KOLONJË

Z. NIKOLLA BENDO DHE ZNJ.RIGOLETA BENDO

Të nderuar!

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 ,neni 55 si dhe VKB Kolonjë Nr.62 datë 25.09.2016 “Miratimin e llojeve të titujve të nderit në Bashkinë Kolonjë” ligjit 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit ,Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë. Këshilli i Bashkisë me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë në dhenien e titullit “QYTETAR NDERI I KOLONJËS” Z.NIKOLLA BENDO.
“Në vlerësim të lartë të kontributit të jashtëzakonshëm shumëdekadësh në shërbim të shëndetit të komunitetit të Kolonjës, si mjek dhe kirurg I përkushtuar. Për profesionalizmin humanizmin dhe ndershmërinë me të cilën ka udhëhequr shërbimin kirurgjikal në Spitalin e Ersekës. Për rolin e tij si një figure shëmbullore që ka lënë gjurmë të thella në jetën publike të qytetit. ” dhe në dhenien e titullit “QYTETAR NDERI I KOLONJËS” Z.RIGOLETA BENDO.“Në vlerësim të kontributit të shquar si mjeke gjinekologe dhe shefe e shërbimit në Spitalin e Ersekës për mbi 25 vite, ku me përkushtim, profesionalizëm dhe kujdes të jashtëzakonshëm, shërbeu në mbrojtje të jetës së grave dhe fëmijëve.Për figurën e saj të nderuar në fushën e mjekësisë, e vlerësuar me “Urdhrin e Mjekut”, dhe për ndikimin e saj të palëkundur në shëndetin publik të rajonit.

JU FALEMINDERIT!

PUNOI:Eni Duro

PRANOI:Elfaneada Dake

KONFIRMOI: Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO